




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority
Nr. i Prot./Br.Prot./Prot. No. 649/24-11/D
Nr. i Fq./Br.St./No. Pg. 1/5
Data/Datum/Date: 27.09.2024
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

Vendimi Nr.87/24

Datë: 27.09.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023 Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës. Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit, në mbledhjen e datës 27.09.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me blerjen e 100% të aksioneve mbi kompanitë (target) Vupik plus d.o.o. Energija Gradec d.o.o. Belje Agro-Vet plus d.o.o. Felix plus d.o.o. nga Podravka Agri, (blerës) dhe Fortenova Group JSC,(shitës).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 22.08.2024, me Nr. Prot. 541/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me blerjen e 100% të aksioneve mbi kompanitë (target) Vupik plus d.o.o. Energija Gradec d.o.o. Belje Agro-Vet plus d.o.o. Felix plus d.o.o. nga Podravka Agri, (blerës) dhe Fortenova Group JSC,(shitës).

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 30.08.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 30.08.2024
3. Transaksioni bazohet Marrëveshjen e Shitblerjes e lidhur më 26.07.2024 ndërmjet PODRAVKA AGRIC d.o.o., si blerës, dhe Fortenova Group d.d., si shitës.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë 1,000,000 Euro.
3. Transaksioni bazohet në Marrëveshjen e Shitblerjes e lidhur më 26.07.2024 ndërmjet Podravka Agri d.o.o., si blerës, dhe Fortenova Group d.d., si shitës.

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, i paraqitur në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe bazuar në nenet 11,13,17,18 si dhe Udhëzimin Administrativ Nr.02/2023 neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve Sekretariati ka filluar vlerësimin e kërkesës për Përqendrim.

Palët në Përqendrim:

Podravka Agri, društvo s ograničenom odgovornošću za upravljanje, me seli të regjistruar në Republikën e Kroacisë, Koprivnica (Qyteti i Koprivnicës), Ulica Ante Starčevića 32, OIB (PIN): 79238637512, MBS, numri i regjistrimit 010143090. Podravka Agri d.o.o., është themeluar në Korrik 2024 si mjet për qëllime të veçanta nga Podravka d.d. me qëllim përvetësimin e 100% të aksioneve në secilën prej Kompanive të Targetit. Prandaj, aktiviteti afarist primar i Podravka Agri d.o.o. është "aktivitetet e menaxhimit të kompanive holding". Aksionari i vetëm i blerësit është shoqëria Podravka d.d., me seli të regjistruar në Republikën e Kroacisë, Koprivnica (Qyteti i Koprivnicës), Ulica Ante Starčevića 32, OIB (PIN): 18928523252, MBS (numri i regjistrimit): 010006549; (blerës). Podravka Agri d.o.o., operon si një kompani aksionare dhe aktiviteti i saj kryesor afarist konsiston në aktivitetet e menaxhimit të kompanive aksionare, dhe konsulencën e biznesit dhe menaxhimit. Podravka d.d., është kompania mëmë e Podravka Group. Podravka Group është i ndarë në dy fusha strategjike të biznesit: ushqim dhe farmaceutikë; Podravka d.d., është kompania mëmë e Podravka Group. Podravka Group është i ndarë në dy fusha strategjike të biznesit: ushqimore dhe farmaceutike, dhe është i organizuar në një seri filialesh në pronësi të plotë të Podravka d.d. Kjo kompani ka të regjistruar një degë në Republikën e Kosovës.

Në tregun e Republikës së Kosovës Podravka Group ka dy filiale të regjistruara. Podravka Sh.a. - Përfaqësia Prishtinë Dega në Kosovë me numër unik identifikues 810503096 dhe adresë ligjore të selisë në S.Vokshi, 3/3, Prishtinë, Kosovë, e cila ushtron aktivitet afarist të agjencive reklamuese, tregti jo të specializuara me shumicë të ushqimeve, pijeve dhe duhanit, si dhe aktivitet ndërmjetësues të specializuar në shitjen e produkteve të tjera të veçanta. Belupo d.d. - Dega në Kosovë”, me adresë ligjore të selisë në rugën Rexhep Luci 16/6, Prishtinë, Kosovë, me numër unik identifikimi 810532946, dhe numër biznesi 70206718. Objekti kryesor i veprimtarisë së saj afariste është hulumtimi i tregut dhe biznesi dhe aktivitete të tjera konsulence menaxheriale.

Fortenova Grupa JSC, e regjistruar në Gjykatën Komerciale në Zagreb, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kroacisë, me seli të regjistruar Zagreb (Grad Zagreb), Rruga Marijana Čavića 1, dhe me numër të regjistrimit të biznesit 081179147; (shitës). Fortenova Grupa JSC është kompania mëmë e grupit Fortenova dhe e Kompanive të Targetit.

Kompanitë Target:

Belje plus d.o.o., me seli në Republikën e Kroacisë, Darda (Komuna e Dardës), Svetog Ivana Krstitelja 1a, OIB (PIN): 35385249539, MBS (numri i regjistrimit): 081180395. Belje plus d.o.o. angazhohet në aktivitetet kryesore të blegtorisë, duke përfshirë mbarështimin e derrave dhe bagëtive, bujqësinë e bimëve, kultivimin e kulturave, kultivimin e domates në serë, vreshtarinë dhe prodhimin e verës.

Pik-Vinkovci plus d.o.o. me seli në Republikën e Kroacisë, Vinkovci (Qyteti i Vinkovcit), Matije Gupca 130, OIB (PIN): 16730830330, MBS (numri i regjistrimit): 081180073. Pik-Vinkovci plus d.o.o. është një kompani bujqësore, aktivitetet kryesore të së cilës janë bujqësia, kultivimi dhe ruajtja e perimeve, si dhe blegtoria, duke përfshirë mbarështimin e derrave dhe të bagëtive

Vupik plus d.o.o. me seli të regjistruar në Republikën e Kroacisë, Vukovar (Qyteti i Vukovarit), Sajmište 113C, OIB (PIN): 81523019624, MBS (numri i regjistrimit): 081180426. Vupik plus d.o.o. është një kompani bujqësore e angazhuar në prodhimin e bimëve, bujqësinë e perimeve, vreshtarinë dhe prodhimin e verës. Për më tepër, Kompania e Targetit menaxhon një port transporti me kapacitet silo në lumin Danub.

Energija Gradec d.o.o. me seli të regjistruar në Republikën e Kroacisë, Sesvete (Qyteti i Zagrebit), Ulica Ljudevita Posavskog 5, OIB (PIN): 83373928482, MBS (numri i regjistrimit): 080761705. Energija Gradec d.o.o. është një kompani që menaxhon impiantet e biogazit në Republikën e Kroacisë.

Belje Agro-Vet plus d.o.o. me seli të regjistruar në Republikën e Kroacisë, Meçe (Komuna e Dardës), Kokingrad 4, OIB (PIN): 90274379825, MBS (numri i regjistrimit): 081179911. Kompania e Targetit Belje Agro-Vet plus d.o.o. është ofrues i shërbimeve veterinare.

Felix plus d.o.o. me seli në Republikën e Kroacisë, Vinkovci, (Qyteti i Vinkovcit), Matije Gupca 130, OIB (PIN): 03636433694, MBS (numri i regjistrimit): 081180196. Felix plus d.o.o. është një kompani bujqësore që merret me bujqësi arë dhe menaxhon tokën bujqësore

Kompanitë e Targetit dhe Shitësi nuk kanë ndonjë filial të regjistruar në Republikën e Kosovës.

Tregu Relevant;

Tregu i produktit: Tregu i shitjes me shumicë të produkteve bimore, dhe tregu i shitjes me shumicë të ushqimit për bagëtinë.

Tregu gjeografik:, tregu përkatës gjeografik mund të përkufizohet si *territorin e Republikës së Kosovës*.

Analiza e konkurrencës:

Blerësi është pjesë e Podravka d.d., e cila është kompania mëmë e Podravka Group. Podravka Group është i ndarë në dy sektorë ushqimorë dhe farmaceutik, në kuadër të kësaj janë të regjistruara dy filiale në Republikën e Kosovës., në sektorin ushqimor dega në Kosovë ushtron aktivitet afarist të agjencive reklamuese, tregti jo të specializuara me shumicë të ushqimeve, pijeve dhe duhanit, si dhe aktivitet ndërmjetësues të specializuar në shitjen e produkteve të tjera të

veçanta, ndërsa në kuadër të sektorit farmaceutik objektivi kryesor i veprimtarisë së saj afariste është hulumtimi i tregut, biznesi dhe aktivitete të tjera konsulencë menaxheriale, sa i përket shitjeve ndërmarrja 77.6% i realizon në segmentin e ushqimit dhe 22.4% në segmentin farmaceutik. Ndërsa kompanitë e Targetit dhe Shitësi nuk kanë ndonjë filial të regjistruar në Republikën e Kosovës mirëpo, produktet bujqësore (farëra të kokoshkave) dhe ushqimet për kafshët në vitin 2023 janë shitur nga i vetmi distributor i tyre i autorizuar në Kosovë e të cilët kanë një prezencë shumë të kufizuar në tregun përkatës. Përmes këtij transaksioni Podravka d.d. synon të ketë një prezencë më të madhe në sektorin bujqësorë në tregun Kroat në tërësi. Kompanitë e Targetit do të vazhdojnë të operojnë si subjekte tregtare të pavarura dhe, pas mbylljes së Transaksionit në fjalë, së bashku me dy fushat strategjike ekzistuese të biznesit të Podravka Group (ushqimore dhe farmaceutike), do të formojnë një njësi të re biznesi, d.m.th. shtylla e tretë e operacioneve të Podravka Group, e cila synon të investojë në modernizimin dhe rritjen e produktivitetit të Kompanive të Targetit përmes investimeve në teknologji të reja, infrastrukturë dhe burime njerëzore

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Duke pasur parasysh se targeti nuk ka ndonjë filiale në Republikën e Kosovës por vetëm realizon shitje përmes distributorit të autorizuar në sektorin e produkteve bujqësore (farëra të kokoshkave) dhe ushqimet për kafshët. Podravka Group si blerës nuk është aktiv në këto tregje në Kosovë dhe se nuk ka mbivendosje të aktiviteteve të palëve në Kosovë në tregun përkatës. Sipas vlerësimit të përqendrimit nga ky transaksion, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Përqendrimin i propozuar nuk implikon mbivendosje të konsiderueshme horizontale në tregun përkatës.

Autoriteti ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Autoriteti, me marrjen e njoftimit të plotë të përqendrimit, në përputhje me nenin 17 paragrafi 3 në paragrafi 3.4, ka publikuar në ueb faqen e vet njoftimin publik, për përqendrimin e synuar, i cili është obliguar të qëndroj 15 ditë, (<https://ak.rks-gov.net>), lidhur me parashtrimin e vërejtjeve, komenteve, në mënyrë që të dhënat e mbledhura të kontribuojnë në sqarimin, pra në kuptim, të marrëdhënies dhe situatës në tregjet përkatëse. Autoriteti, nuk ka pranuar asnjë reagim, nga palët e interesuara.

Shënim:

Çdo formë e shtrebbërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare



III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva